

AKT THEMELIMI DHE STATUT "BALKANS LEGAL PARTNERS" SHPK

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"BALKANS LEGAL PARTNERS" SHPK

A handwritten signature in black ink, consisting of several loops and a vertical stroke, positioned in the lower center of the page.

AKT THEMELIMI DHE STATUT "BALKANS LEGAL PARTNERS" SHPK

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISQË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "BALKANS LEGAL
PARTNERS" SHPK

KREU
EMRI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1
EMRI I SHOQËRISË

- 1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "BALKANS LEGAL PARTNERS" SHPK, (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

NENI 2
SELIA

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Blv. Zhanë D'ark; Nd. 111; H. 1, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3
KOHËZGJATJA

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.

NENI 4
OBJEKTI I SHOQËRISË

- 4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në: (PENALE), Konsulencë dhe asistencë ligjore gjatë procesit penal, duke filluar që nga momentet e para të ndjekjes penale, ndalimit, arrestimit, gjatë fazës së marrjes në pyetje, njoftimit të akuzës së të pandehurit, si dhe gjatë gjyqimit të çështjes në gjykatë deri në daljen e vendimit përfundimtar. Konsulencë ligjore dhe përfaqësim të klientëve të saj përpara organeve hetimore, përpara Prokurorisë, si dhe përpara Gjykatës, në të gjitha statuset e mundshme që mund të përballen klientët tanë, si: person nën hetim, person që i atribuohet vepra penale, si i pandehur, si i dënuar, apo si i dëmtuar nga vepra penale. Përfaqësim dhe mbrojtje të të drejtave të personave të ndaluar gjatë fazës së vendosjes së masave të sigurimit, vleftësim arresti, ndalimi, ankim ndaj masave të sigurimit, paraqitje kërkesash për zëvendësim ose revokim mase

AKT THEMELIMI DHE STATUT "BALKANS LEGAL PARTNERS" SHPK

sigurimi. Përfaqësim gjatë hetimeve paraprake, përpilim kërkesash fillestare, akte juridike, memorie, në lidhje me mbrojtjen ligjore përpara organit të akuzës. Konsulencë dhe ankimim të vendimeve të ndërmjetme që merr organi i akuzës, pjesëmarrje në zhvillimin e procedurës hetimore nga ky organ, duke kërkuar kopje të provave apo duke paraqitur prova në favor të personave të ndaluar, që shërbejnë për marrjen e vendimit nga organi i akuzës. Konsulencë ligjore dhe përfaqësim gjyqësor duke marrë në mbrojtje klientët tanë gjatë zhvillimit të procesit penal, duke i mbrojtur dhe përfaqësuar në të gjitha shkallët e gjykimit. Konsulencë ligjore në nënshkrimin e akteve juridike, kërkesa, memorie, prapësime, rekurse dhe kërkesa për rishikim vendimi penal të formës së prerë, si dhe përfaqësim në Gjykatën e Lartë. Ankime kundër vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe përfaqësim gjyqësor në Gjykatën e Lartë dhe atë Kushtetuese, për çështje që lidhen me respektimin e procesit të rregullt ligjor dhe me paligjshmërinë e vendimeve të dënimit të dhëna në disfavor të klientëve. Konsulencë në hartimin e të gjitha llojeve të kërkesave, ankimeve dhe rekurseve që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimit të dalë nga gjykata kompetente në mbrojtje të interesave të klientit. Asistencë ligjore dhe përfaqësim në çështjet që lidhen me kërkesat për falje, ulje dënimi, lirim me kusht, pezullim të ekzekutimit të dënimit dhe vënien në provë, parashkrim të ekzekutimit të dënimit, kompensim për dënim të padrejtë etj. Asistencë ligjore në proceset që lidhen me procedurat e ekstradimit dhe transferimit të të dënuarve me shtetësi shqiptare apo të huaj, me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale të huaja në Republikën e Shqipërisë. Hartimin e kërkesave për kompensimin e burgimit të padrejtë dhe përfaqësimin e tyre në procesin gjyqësor për këtë çështje. (CIVILE), Konsulencë juridike, hartim të kërkesë-padive, përfaqësim gjyqësor, në lidhje me fitimin dhe mbrojtjen e së drejtës së pronësisë dhe bashkëpronësisë. Konsulencë juridike përfaqësim gjyqësor, në lidhje me formën ligjore të lindjes, ndryshimit, shuarjes së marrëdhënieve juridike të detyrimit apo atyre kontraktore. Konsulencë në përpilim kontratash të të gjitha llojeve, përfshirë këtu edhe kontratat aksesore si mjete të sigurimit për përmbushjen e detyrimeve. Konsulencë juridike për çështjet e trashëgimisë ligjore dhe testamentare, përfaqësim në gjykatë për çeljen e trashëgimisë ligjore, kundërshtim të testamentit etj. Hartimin e kërkesë-padive dhe përfaqësimin e çështjeve në gjyq gjatë procesit gjyqësor për shpërblimin e dëmit moral apo ekzistencial, si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të kryera në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Hartimin e kërkesave për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara si rezultat i aksidenteve rrugore nga mjetet motorrike. Përfaqësim në gjykatë kundër Shoqërive të Sigurimit për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara nga mjetet motorrike apo dhe kundër Byrosë Shqiptare të Sigurimit. Konsulencë juridike, përfaqësim gjyqësor, hartim dokumentacioni, për çështjet e pasurisë që kanë të bëjnë me regjistrimin e tyre pranë Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, etj. Përfaqësim ligjor pranë gjykatave të rretheve gjyqësore të ndryshme, Gjykatave të Shkallës Parë dhe të Apelit, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Përgatitje të kërkesë-padive dhe akteve të tjera juridike.



AKT THEMELIMI DHE STATUT "BALKANS LEGAL PARTNERS" SHPK

Përgatitje të kërkesave të ndryshme drejtuar institucioneve të ndryshme: ankime, rekurse, njohje të vendimeve të huaja për efektet civile, etj. (PASURI TË PALUAJTSHME), Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme pranë Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pajisjen me titullin e pronësisë, si dhe çdo problem tjetër, që ka lidhje me pronat e paluajtshme. Ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore për investime në pasuri të paluajtshme. Procedurat që duhen ndjekur për shitjen e pasurive të paluajtshme, marrjen me qira, shfrytëzimin, servitutet etj. Konsulencë juridike në lidhje me fitimin e pronësisë, procedurat që duhet të ndiqen në rastin e fitimit të pasurive me parashkrim fitues, si dhe regjistrimin e tyre në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. (FAMILJARE), Zgjidhje martesë dhe përfaqësim përpara organeve gjyqësore; Ndarjen e pasurisë së përbashkët, pjesëtim pasurie. Caktim detyrimi ushqimor, kundërshtimi i tij, apo ndryshimi i masës së pensionit ushqimor. Kundërshtim atësie, amësie të fëmijëve. Si dhe çdo problem tjetër që ka lidhje me çështjet familjare. (ADMINISTRATIVE), Hartim të dokumentacionit të nevojshëm. Përfaqësim ligjor në konfliktet me organet administrative shtetërore. Ankim të akteve administrative individuale. Asistencë dhe përpilim të dokumentacionit për pjesëmarrje në tendera, propozimin dhe përgatitjen e konçensioneve, marrjen e lejeve, etj. Konsulencë dhe asistencë në komunikim me organet e adiministratës shtetërore. Konsulencë dhe asistencë në lidhjen e kontratave me organet e administratës shtetërore. Ankimim gjyqësor i akteve administrative dhe përfaqësim gjyqësor përpara Gjykatave të Shkallës së Parë, të Apelit, dhe të Gjykatës së Lartë. Përfaqësim në gjykimet për kontrollin e ligjshmërisë së aktit në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese. Përpilim kërkesash fillestare, peticione me gojë ose me shkrim, me anë të mjeteve të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, akte juridike, memorie, në lidhje me procedimet administrative ku klientët tanë janë palë. Ankim ndaj vendimeve të ndërmjetme që merr organi administrativ, pjesëmarrje në zhvillimin e procedurës hetimore nga organet administrative, duke kërkuar verifikimin e provave, duke paraqitur prova që shërbejnë për marrjen e vendimit nga ana e tij. Hartim dokumetacioni dhe ndjekje të procedurave të tenderave dhe prokurimeve publike. (INVESTIM), Parapagimi dhe financimi i shpenzimeve gjyqësore të tarifave të noterëve, të avokatëve bashkëpunëtor të shoqërisë, ekspertëve të caktuar nga Gjykata, taksave të kërkesëpadisë, 1%, etj. për llogari të klientëve, kundrejt një norme interesi mujor ose vjetor për të cilën palët bien dakord. (FINANCIARE), Shërbim të kualifikuar në fushën e legjislacionit tatimor, në rrugë gjyqësore dhe administrative. Zgjidhjen e problemeve tatimore të klientëve të saj, duke ofruar konsulencë mbi sistemin tatimor dhe doganor në Republikën e Shqipërisë, duke ndërmjetësuar në zgjidhjen e konflikteve, apo duke ofruar konsulencë në përgatitjen e ankimeve ndaj vendimeve të organeve tatimore dhe doganore. (TREGTARE), Konsulencë dhe asistencë juridike për shoqëritë tregtare, në formën ligjore të ushtrimit të veprimtarisë tregtare, në hartimin e dokumentacionit të nevojshëm që ka të bëjë me: Themelimin e shoqërive tregtare, përgatitjen e akteve të themelimit, regjistrimin pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe pranë organeve të tjera të administratës

AKT THEMELIMI DHE STATUT "BALKANS LEGAL PARTNERS" SHPK

shtetërore. Hartim statutesh dhe akte themelimi për shoqëritë tregtare. Administrimin e shoqërive tregtare, ndryshimet statutores, marrëdhëniet midis ortakëve, shitblerje të aksioneve dhe kuotave të shoqërisë, për mënyrën dhe formën ligjore të rritjes apo zvogëlimit të kapitalit themeltar të shoqërive tregtare, etj. Ndryshimin e formës ligjore të shoqërive nëpërmjet bashkimit, shndërrimit dhe likuidimit. Marrëdhëniet e shoqërisë tregtare me palët e treta. Përfaqësim në gjyq të shoqërive tregtare për çështje civile dhe administrative, si dhe përpara të gjitha organeve administrative apo institucioneve të ndryshme. (BANKARE), Shërbim të kualifikuar në fushën e legjislacionit financiar në Republikën e Shqipërisë, shërbim i cili konsiston në: Konsulencë juridike dhe plotësim dokumentacioni për përfitimin e kredive bankare. Hartim dokumentesh, aktesh, përfaqësim në gjykatë, në mbrojtje të klientëve debitorë apo kreditorë ndaj bankave të nivelit të dytë. (KONTRATA), Konsulencë ligjore në hartimin dhe nënshkrimin e të gjitha tipologjive të kontratave në mes palëve, persona fizikë apo juridikë, privatë apo shtetëror. Konsulencë juridike në lidhje me formën ligjore të lindjes, ndryshimit, shuarjes së marrëdhënieve juridike të detyrimit apo marrëdhënieve të tjera kontraktore. Konsulencë në përpilim kontratash të të gjitha llojeve, përfshirë këtu edhe kontratat aksesore si mjete të sigurimit për përmbushjen e detyrimeve. (PUNËSIMI), Konsulencë ligjore dhe përfaqësim përpara të gjitha gjykatave në të gjitha shkallët e gjyqimit, për çështje në fushën e së drejtës së punës, që kanë të bëjnë me: Hartimin e kontratave individuale dhe kolektive të punës. Përfaqësimin në proçese gjyqësore, duke kundërshtuar largimin nga puna, si dhe duke kërkuar respektimin dhe shpërblimin e të gjitha detyrimeve nga ana e punëdhënësit, në rastet e largimit nga puna në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Përfaqësimin në proçese gjyqësore, duke kundërshtuar largimin nga puna dhe duke kërkuar kthimin në punë në rastin e personave që gëzojnë statusin e nëpunësit civil. Çështje që kanë të bëjnë me të drejtën për përfitimin e pensionit të pleqërisë. Mosmarrëveshje të ndryshme që kanë të bëjnë me sigurimet shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë. Mosmarrëveshje që kanë të bëjnë me pagat, me detyrat e punëmarrësit në punë, uljet në detyrë apo dhe çdo problem tjetër që mund të lindë në mes palësh. Dëmtime dhe sëmundje në punë, etj. Çështje që kanë të bëjnë me pezullimin, kundërshtimin apo mosnjohjen e së drejtës së përfitimit të pensionit të pleqërisë. (EMIGRACIONI), Ndjekjen e të gjitha praktikave që kanë të bëjnë me lejet e qëndrimit dhe të punës për të huaj, si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm për shtetasit e huaj që jetojnë apo punojnë në Republikën e Shqipërisë. Ndjekja dhe asistenca në të gjitha fazat që kanë të bëjnë me aplikimin dhe pajisjen me dokumentin e kërkuar nga shtetasit e huaj. (INTELEKTUALE), Shërbim në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin kombëtar apo ndërkombëtar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave, të markave tregtare, patentave, dizenjove industriale, treguesve gjeografikë, përfshi këtu aplikimin dhe regjistrim e patentave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ndjekjen e këtyre proçedurave pranë institucioneve përkatëse. Konsulencë ligjore në regjistrimin e liçensave, në aplikimin për ripërtëritje etj. Konsulencë dhe përfaqësim në gjykatë në rast shkeljesh të të drejtave që kanë lidhje me

AKT THEMELIMI DHE STATUT "BALKANS LEGAL PARTNERS" SHPK
pronësinë intelektuale. (ARBITRAZH), Përfaqësim ligjor në Arbitrazh
Kombëtar dhe Ndërkombëtar.

4.2 Për përmbushjen e objektit të saj Shoqëria:

- a) Mund të marrë pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose të subjekteve pjesëmarrëse;
- b) Mund të lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë, bashkë investitorë, pronarë truall apo objektsh, operatorë dhe administrues të firmave ligjore;
- c) Mund të kryejë të gjithë veprimet e nevojshme ose të dobishme ose që kanë të bëjnë, përfshirë por pa u kufizuar në: ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe së të tretëve, veprime me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, tregtare dhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose që mundëson një përdorim më të mirë të strukturave dhe/ose burimeve nëpërmjet shoqërive ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt, Shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre.

4.3 Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës me qëllim të përmbushë ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

KREU II

KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

NENI 5

KAPITALI I SHOQËRISË

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është 5.000, (Pesëmijë) Lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë. Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga ortakët që zotërojnë 100 %, (njëqind për qind), të kontributeve në kapitalin e shoqërisë, përkatësisht:
- Znj. Dorina Cala, shtetase shqiptare, e lindur në Tiranë, më 10.06.1987, identifikuar me Letër Njoftimi ID me numër 038114128 dhe me numër personal I75610096U, e cila zotëron 100 %, (njëqind për qind), të kapitalit;
- 5.2 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 6

KALIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMNI OSE SI PASOJË E FALIMENTIMIT

- 6.1 Në rast se një ortak apo një bashkëzotërues i një kuote humb jetën, trashëgimtarët e tij do të jenë të vetmit persona që do të njihet titulli mbi kuotën nga Shoqëria; por asnjë nga këto parashikime nuk liron përgjegjësitë e trashëgimtarëve nga çdo detyrim i mbartur nga kuota e zotëruar. Në rastin e vazhdimit të shoqërisë me disa trashëgimtarë të ortakut që ka humbur jetën, trashëgimtarët duhet të caktojnë një përfaqësues të përbashkët.

AKT THEMELIMI DHE STATUT "BALKANS LEGAL PARTNERS" SHPK

- 6.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të një ortaku mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse personi i mësipërm zgjedh të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër atëherë ai duhet ta kryejë atë nëpërmjet një akti të vlefshëm të transferimit të kuotës.
- 6.3 Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në regjistrin tregtar si zotërues i kuotës.

NENI 7 ZMADHIMI I KAPITALIT

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakeve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 7.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjesëtim të drejtë me kuotat që zotërojnë në Shoqëri.
- 7.3. Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panënshkruar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sërish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

NENI 8 ZVOGËLIMI I KAPITALIT

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast, kapitali i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.
- 8.2 Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë, në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë.

KREU III ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

NENI 9 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

AKT THEMELIMI DHE STATUT "BALKANS LEGAL PARTNERS" SHPK

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të shoqërisë.
- 9.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.
- 9.3 Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një përfaqësues i deleguar me prokurë me shkrim.
- 9.4 Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën e votës për një pjesë të kuotave të tijtë kapitalit, nëse ai voton personalisht për pjesën e mbetur.
- 9.5 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortaket ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*) audio ose video, në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 9.6 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/et ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara shoqërisë, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.
- 9.7 Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, në rast se të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord për rendin e ditës.
- 9.8 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori/et. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.
- 9.9 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakeve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 9.10 Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në Vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 9.11 Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortaket me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë me shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të shoqërisë, përveç rasteve të parashikuara më poshtë në nenin 9.12. Në rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme thirret në një mbledhje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja e parë.
- 9.12 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të $\frac{3}{4}$ të ortakëve pjesëmarrës apo të përfaqësuar që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë për ndryshimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e

AKT THEMELIMI DHE STATUT "BALKANS LEGAL PARTNERS" SHPK
kapitalit të shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e
shoqërisë.

**KREUIV
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

**NENI 10
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

- 10.1 Shoqëria administrohet nga një apo më shumë Administratorë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë prej 5(pesë) vjetësh. Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.
- 10.2 Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të shoqërisë, përveç atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut ia rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të shoqërisë.
- 10.3 Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e shoqërisë.
- 10.4 Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të shoqërisë, në rast konflikti interesi, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.
- 10.5 Administratori i parë i shoqërisë do të jetë:
- Znj. Dorina Cala, shtetase shqiptare, e lindur në Tiranë, më 10.06.1987, identifikuar me Letër Njoftimi ID me numër 038114128 dhe me numër personal I75610096U, e cila zotëron 100 %, (njëqind për qind), të kapitalit;

**NENI 11
SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT**

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërblimin e Administratorit të shoqërisë.

**NENI 12
PËRFUNDIMI I DETYRËS SË ADMINISTRATORIT**

- 12.1 Detyra e Administratorit përfundon në rast se:
- (a) i përfundon mandati;
 - (b) shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme;
 - (c) jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqërinë;
 - (d) personi nuk gëzon cilësinë e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;



AKT THEMELIMI DHE STATUT "BALKANS LEGAL PARTNERS" SHPK
(e) mungon pa arsye në detyrë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj
radhazi dhe Asambleja e Përgjithshme vendos ta shkarkojë nga
detyra.

KREU V
KONTROLI FINANCIAR I
SHOQËRISË, VITI FINANCIAR, BILANCI
VJETOR, DIVIDENDI

NENI 13
KONTROLI FINANCIAR

13.1 Kontrolli financiar i shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

NENI 14
VITI FINANCIAR

14.1 Viti Financiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 15
BILANCI VJETOR

- 15.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e shoqërisë si edhe llogaritë vjetore.
- 15.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 16
DIVIDENDI

- 16.1 Pasi të jenë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë të Përgjithshme, mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- 16.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që i bashkëngjiten kuotave, të gjithë dividendët duhet të deklarohen dhe paguhen sipas shumave të paguara në kuotat në të cilat paguhet dividendi. Të gjitha dividendët do të shpërndahen dhe paguhen në mënyrë proporcionale me shumatat e paguara mbi kuotat gjatë çdo pjese ose pjesëve të periudhës në të



AKT THEMELIMI DHE STATUT "BALKANS LEGAL PARTNERS" SHPK
cilën paguhet dividendi.

KREU VI
PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I
ZBATUESHËM, ZGJIDHJA E
MOSMARRËVESHJEVE

NENI 17
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

17.1 Në rastin e prishjes dhe likuidimit të shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

NENI 18
LIGJI I ZBATUESHËM

18.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

NENI 19
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet shoqërisë dhe ortakeve, apo ndërmjet ortakeve dhe trashëgimtarëve të ortakeve ose ortakëve të tjerë dhe/ose shoqërisë, që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen miqësisht ndërmjet palëve të interesuara, në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT

DORINA CALA

Dorina Cala
DC

Datë 16.03.2022